



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.14.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË PËR
KOMUNITETE DHE KTHIM
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi (Udhëheqës ekipi) dhe Erëmira Bytyqi-Pllana (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	26
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	27
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	30
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	33

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Auditimit¹, të datës 25/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i i pakualifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Si Theksim i çështjes ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuria fikse në vlerë prej 638,279€ nuk është shpalosur në PFV. Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe informatat jo të sakta rreth pasurive janë reflektuar në PVF dhe kanë ndikuar në theksim të çështjes.



Ministri duhet t'i analizojë arsyet për theksimin e çështjes dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezentim të drejtë dhe të vertetë të informatës financiare në PVF 2017.

Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak ishte adresuar, por jo në nivelin e duhur, siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet te kapitulli Qeverisja).

Procedurat e menaxhimit financiar dhe kontrollit janë përcjellur me mangësi të shumta në të gjitha fushat e shpenzimeve.



Ministri duhet të sigurojë që është bërë një verësim i detajuar lidhur me proceset e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit dhe proceseve të tjera përcjellëse të theksuara në këtë raport, për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet te kapitulli Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli).

Si pasojë e kontrolleve jo adekuate, regjistrat e pasurive kapitale jo kapitale nuk janë të besueshme dhe të sakta.



Ministri duhet të ndërmarrë masa shtesë mbi kontrollet e mbikëqyrjes, menaxhimit dhe raportimit të pasurisë përmes një procesi, në të cilin përveç zyrtarit përgjegjës të pasurisë, janë të kyqur edhe zyrtarë të tjerë sipas kompetencave të raportimit dhe llogaridhënies, për të nxjerrë regjistra të saktë të pasurisë (nënkapitulli Pasuria jo financiare).

Përgjigja e Ministrit - auditimi 2016

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuria kapitale në vlerë prej 638,279€, nuk është regjistruar në SIMFK si investim në vijim. Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB, neni 13, transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për Organizatat Buxhetore (OB), duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. MKK ishte në proces të ndërtimit të pasurive për Komunitat dhe kishte kryer pagesa nga kategoria e investimeve kapitale, mirëpo këto pagesa nuk reflektonin si pasuri në regjistrat përkatës, edhe pse pronësia ende nuk ishte bartur te Komunitat. Kjo ka ndikuar që vlera e pasurisë kapitale në PFV të jetë e nënvlerësuar.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria për Komunitete dhe Kthim kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
- Kërkesat buxhetore; raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara;
- Raportimin mujor të obligimeve të papaguara; etj

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në MF, konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Sa i përket kërkesave tjera të raportimit, MKK ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. Megjithatë në kuadër të cilësisë së raporteve ne identifikuan mos pajtueshmëritë si në vijim:

- Në planin e prokurimit nuk ishin të përfshira të gjitha aktivitetet e realizuara për kontrata furnizimi dhe shërbime; dhe
- MKK nuk ka bërë plane të detajuara, për aktivitetet e planifikuara për kontrata pune, mirëpo të gjitha ato janë kategorizuar në tri (3) projekte kapitale, si: Projekti për kthim “Ndërtimi i shtëpive për të zhvendosurit”, Projekti për komunitete, dhe Projekti “Kthimi dhe ri integrimi në Kosovë – RRK IV” i bashkë financuar nga Bashkësia Evropiane dhe Qeveria e Kosovës.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për dy (2) çështjet e sipërpërmendura me lartë ne japim rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë që të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Në këtë aspekt, duhet të ndërmerren veprime për adresimin e shkaqeve në mënyre sistematike dhe praktike për t'i eliminuar gabimet në regjistrimin pasurive kapitale, për të siguruar regjistra të saktë të pasurive në posedim të Organizatës; dhe

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar se informatat e raportuara për menaxhmentin dhe palët tjera të interesit të rishikohen në mënyrë kritike para se ato të dorëzohen, me qëllim të evitimit të kësaj dukurie. Plani final i procedurave të prokurimit duhet t'i përfshijë të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit të ri fiskal.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Menaxhmenti ishte angazhuar për ta bërë një numër përmirësimesh në qeverisje të mirë duke zbatuar një proces formal të zbatimit të rekomandimeve të vitit të kaluar, edhe pse një pjesë e tyre kanë mbetur të pa zbatuara.

Megjithatë ende vërehen mangësi në qeverisje brenda MKK-së veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit. Pyetësi i vet-vlerësimit e pasqyron këtë situatë pjesërisht me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese të qeverisjes së mirë që nuk bazohen në dëshmi të mjaftueshme. Aranzhimet e tjera, të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes së mirë, do të ishin përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, të cilat janë të vendosura por nuk funksionojnë në mënyrë efektive.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të MKK-së kishte rezultuar me 13 rekomandime kryesore. MKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, nga 13 rekomandime, tetë (8) janë zbatuar plotësisht, ndërsa tri (3) janë në proces, si dhe dy (2) të pa zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraparak – Prioriteti i lartë

E gjetura Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një proces formal të menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të vitit të kaluar të AP-së, nuk është arritur që plani i veprimit të përmbushet në tërësi. Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve kanë mbetur në proces të zbatimit, ose të pa zbatuara. Si pasojë e kësaj çështjet e njëjta janë përsëritur edhe këtë vit.

Rreziku Mos implementimi i rekomandimeve ka ndikuar në përsëritjen dobësive të vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sistemet financiare.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë që të zbatohet plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, në bashkëveprim me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për 2016 më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, ne i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Bazuar në këtë kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit të plotësuar nga MKK ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. MKK e ka hartuar regjistrin e përgjithshëm të rreziqeve, në të cilin i ka identifikuar sfidat dhe vështirësitë, me të cilat përballet gjatë aktiviteteve të përditshme, mirëpo nuk janë identifikuar rreziqet e përcjella prej vitit në vit, me të cilat është e ballafaquar organizata. Në disa raste të identifikimit të rreziqeve nuk janë dokumentuar masat apo veprimet që synohen të ndërmerren në tejkalimin e tyre. Në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme përshkrimi i rreziqeve ishte i mangët dhe nuk korrespondonte me përshkrimin e masave të ndërmarra. Njëherit ky departament nuk e kishte identifikuar rrezikun e regjistrimit të pasurisë, raportimin e vlerës së saktë dhe harmonizimin e raporteve të organizatës dhe raporteve të SIMFK-së; dhe
2. Koordinimi për planifikim të blerjeve vjetore në mes të njërive kërkuese dhe prokurimit, përfshirë financat dhe buxhetin nuk është procesuar si duhet. Nga dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion edhe pse raportet janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.

MKK e kishte caktuar zyrtarin përgjegjës për përcjelljen e procesit, proces i cili është finalizuar nga një komision i caktuar me vendim të menaxhmentit që ta përgatisë regjistrin e përgjithshëm të konsoliduar të organizatës. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vet-vlerësimi i vitit 2016 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qasjes objektive në përcaktimin e rreziqeve dhe adresimin e tyre nga secila njësi që ishte obliguar t'i identifikoj rreziqet e veta.

Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të sigurojë që të rishikohet plotësimi i pyetësit të vet-vlerësimit dhe të bëhet adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit të vet-vlerësimit dhe për ta siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MKK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar që sistemet financiare funksionojnë, siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë lidhur me problemet operative të identifikuara.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti kishte vendosur një strukturë organizative adekuate, kishte bërë delegimin e detyrave dhe përgjegjësi dhe ishte i informuar për proceset e zhvilluara në kuadër të ministrisë. Me përjashtim të Zyrtarit Çertifikues, Departamentet dhe divizionet përgatitin raporte të rregullta drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, i cili po ashtu organizonte takime pune të rregullta me udhëheqësit e njësive, të cilat përcilleshin me procesverbale.

Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Pavarësisht se linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta, raportimet menaxheriale nuk ishin sa duhet efektive, në mënyrë që të mundësonin një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Me theks të veçantë, kontrollet ishin jo efektive në fushën e investimeve kapitale, subvencioneve, prokurimit, si dhe në menaxhimin e pasurisë. |
| Rreziku | Mungesa e kontrolleve efektive e redukton efektivitetin e menaxhimit dhe raportimit financiar brenda MKK-së, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe me rrezikun për shpenzime të parregullta me vlera materiale. |
| Rekomandimi 5 | Ministri duhet t'i shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë eliminimin e dobësive në procesin e shpenzimeve dhe raportimit. |

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre (3) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy (2) auditor. Për ta kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që i reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet e tjera të MKK-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga Komiteti i Auditimit (KA).

NjAB ka hartuar planin strategjik dhe vjetor, në të cilin kishte planifikuar shtatë (7) raporte të auditimit, të cilat u finalizuan deri në fund të vitit 2016. Përmes këtyre raporteve kishte audituar divizionet në kuadër të departamentit të administratës së përgjithshme, divizionin për buxhet e financa, divizionin e prokurimit, divizionin e personelit, divizionin e IT-së dhe Logjistikës. Gjatë vitit 2016, KA, kishte mbajtur katër (4) takime. Çështjet e ngritura nga raportet e auditimit të brendshëm ishin vlerësuar dhe trajtuar prej tyre.

Në raportet e auditimit të brendshëm ishin dhënë gjithsej 43 rekomandime. Prej tyre 31 ishin zbatuar, ose 72%, ndërsa pjesa tjetër ose janë në proces të zbatimit ose kanë mbetur të pa zbatuara. Inkurajojmë menaxhmentin të hartojë një plan për zbatimin e plotë të tyre.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MKK në përgjithësi kishte kontrole të relativisht të mira në raport me obligimet statutores të saj. Megjithatë, menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët e sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, MKK ka përdorur 91% të buxhet final, më një nivel të njëjtë të shpenzimit në raport me vitin paraprak, megjithëse këtë përqindje kanë ndikuar edhe vendimet e Qeverisë për reduktimin e fondeve në fund të vitit.

Në kontekst të sistemeve financiare nevojitet përmirësim në kontrollet mbi shpenzimet, me theks të veçantë mbi investimet kapitale dhe menaxhimin e subvencioneve. Për më tepër menaxhimi dhe raportimi i pasurisë ishte përcjelle me shume mangësi. Regjistrat e pasurisë nuk ishin të saktë.

Është e nevojshme të vlerësohet secila prej shkaqeve që kanë ndikuar në performancën jo të mirë në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit, në mënyrë që të përcaktohet mënyra e adresimit të tyre për t'i përmirësuar menaxhimin e tyre.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,637,008	8,479,771	7,678,677	7,107,326	7,088,790
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,637,008	8,479,771	7,678,677	7,107,326	7,088,790

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 842,763€. Kjo rritje është rezultat i disa vendimeve të nxjerra nga Qeveria e Kosovës për mbështetjen dhe zbatimin e tyre nga MKK.

Në vitin 2016, MKK ka përdorur 91% të buxhetit final ose 7,678,677€. Nivel të njëjtë të ekzekutimit të buxhetit kishte edhe në vitin 2015.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,637,008	8,479,771	7,678,677	7,107,326	7,088,791
Pagat dhe Mëditjet	735,202	757,545	752,433	657,233	597,693
Mallrat dhe Shërbimet	375,652	339,590	339,439	351,629	580,584
Shërbimet komunale	26,154	17,987	17,987	12,643	25,525
Subvencionet dhe Transferet	300,000	300,000	299,993	268,877	297,882
Investimet Kapitale	6,200,000	7,064,649	6,268,824	5,816,944	5,587,107

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final në kategorinë për paga dhe mëditje është rritë për 22,343€, për shkak të rritjes së numrit të punëtorëve me rekomandimet e dala nga bisedimet e Brukselit;
- Ka pasur shkurtime buxhetore për mallra dhe shërbime në vlerë prej 36,052€ dhe për shërbime komunale në vlerë prej 8,176€ me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore;
- Buxheti për investime kapitale ishte rritë për 864,649€. Fillimisht me ligjin 05/L-109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.05/2-071 për buxhetin për vitin 2016 është rritë për 944,632€ për t'i mbuluar projektet në Mitrovicën Veriore. Këto mjete janë kategorizuar me kod të veçantë projekti dhe kanë hyrë në kodin e programit të administratës qendrore. Ndërsa më pas, me vendim të Qeverisë Nr-011/123 të dt. 28/12/2016 është shkurtuar buxheti në vlerë 129,982€.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për paga dhe mëditje për vitin 2016 ishte 757,545€, ndërsa shpenzimet ishin 752,433€ apo shprehur në përqindje rreth 99% e buxhetit.

Kontrollet në fushën e burimeve njerëzore nuk ishin plotësisht efektive, mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afatit ligjor si dhe dobësitë tek dosjet e personelit. Në vijim kemi shpalosur mangësitë e identifikuara:

Çështja 6 - Tejkalimi i afatit ligjor për pozitat e mbuluara me Ushtrues Detyre - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas ligjit për shërbimin civil, neni 30, në rast të pozitave të lira, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Në MKK, pozita e Sekretarit të Përhershëm mbulohet me ushtrues detyre që nga viti 2013 dhe ajo e Drejtorit të Departamentit për Politika dhe Analiza nga viti 2014.

jo kishte ndodhur, për shkak se konkurset e shpallura për pozitën e Sekretarit të Përhershëm ishin anuluar pasi që aplikantët nuk i kishin përmbushur kriteret e caktuara. Ndërsa pozita e Drejtorit të Departamentit për Politika dhe Analiza nuk plotësohet për shkak se me Akt emërim kjo pozitë i takon personit që aktualisht është U.D. në pozitën e Sekretarit të Përhershëm.

Rreziku Mbulimi i pozitave të rëndësishme me UD për një kohë kaq të gjatë, rrit rrezikun që performanca e realizuar dhe përgjegjësia në këto pozita të mos jetë në nivelin e kërkuar.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë që procedurat e rekrutimit fillojnë më kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më Udhëzimin Administrativ.

Çështja 7 - Mangësitë në dosjet e personelit - Prioritet i mesëm

E gjetura Në përshkrimin e detyrave të punës për pozitat “Udhëheqës i Divizionit për Kthim dhe Komunitete” dhe “Nëpunës për të Drejtat e Njeriut”, kërkohet posedimi i diplomës universitare. Në dosjet personale të dy nëpunësve që ushtrojnë këto pozita kemi vërejtur se kanë munguar diplomat universitare. Megjithatë, në fazën finale të auditimit, na është siguruar vërtetimi për diplomimin e zyrtares në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Kthim dhe Komunitete”, ndërsa për zyrtaren tjetër, personeli nuk ka mundur të na e sigurojë diplomën me arsyetimin se ende nuk është e pajisur me diplomë.

Rreziku Ushtrimi i pozitave në mungesë të kriterëve të kërkuara rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e procedurave të personelit në mënyrë që të gjithë të punësuarit t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës për pozitat përkatëse.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për kategorinë mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale ishte 357,577€. Shpenzimet e realizuara në për vitin 2016 ishin 357,427€, ose afro 100%. Në bazë të testimeve tona, kemi vërejtur se disa kontrolle nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe dobësitë e hasura i kemi paraqitur më poshtë:

Çështja 8 - Blerja e mallrave (mobileve) për një organizatë tjetër buxhetore, pa kompensim nga kjo e fundit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas LMFPP, neni 32, në rast se një Organizatë Buxhetore (OB) pranon mallra nga një OB tjetër, atëherë kjo e fundit duhet të kërkojë që këto mallra të paguhen në bazë të kthimit të kostos. MKK kishte blerë mallra (mobileje) në vlerë prej 9,938€ për Komunën e Shtërpcës në formë të mbështetjes financiare, bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës. Në këtë rast është shpenzuar buxheti nga kategoria mallra dhe shërbime e planifikuar për nevojat e MKK-së dhe nuk është kërkuar kompensim nga Komuna. Për më tepër këto lloje të shpenzimeve i takonin kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Zyrtarët përgjegjës nuk ishin të informuar se ky lloj transaksioni është në kundërshtim me ligjin.
- Rreziku** Shpenzimi i buxhetit të ndarë për nevoja të brendshme të ministrisë, për përfitime të organizatave tjera buxhetore, rrezikon mosarritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu, kjo ndikon në mbivlerësimin e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësimin e subvencioneve dhe transfereve.
- Rekomandimi 8** Ministri të sigurohet se janë duke u zbatuar kërkesat ligjore në lidhje me shpenzimin e parasë publike për kategori. Mjetet e ndara për nevoja të brendshme të organizatës të shfrytëzohen vetëm për këtë qëllim të përcaktuara.

Çështja 9 - Kompensimi i shtesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve – prioritet i mesëm

E gjetura Sipas ligjit të buxhetit, neni 11, shpenzimi i parave publike nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve nuk është e lejuar për pagesën e punonjësve. MKK, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ka paguar kompensimin ndaj një të punësuarë në vlerë prej 9,000€. Të punësuarës nuk ju kanë paguar shtesat gjatë periudhës 2009 – 2012, andaj këtë e kanë bërë në forme retroaktive. Për shkak të mungesës së mjeteve në kategorinë e pagave, ishin shfrytëzuar mjetet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, respektivisht nga kodi shërbimet për arsim.

Rreziku Kompensimi i shtesave për të punësuarit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, duke qenë në kundërshtim me rregullat financiare, ndikon në shpenzimin e mjeteve në mënyrë jo të planifikuar dhe mbivlerësimin e shpenzimeve në këtë kategori.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat të gjithë të punësuarve të nevojshëm, përfshirë edhe pagat retroaktive. Me pas, çfarëdo kompensimi në lidhje me shtesat ndaj punonjësve, të paguhen vetëm nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Çështja 10 - Siguria e ekzekutimit të tenderit në afat më të shkurtër se afati i skadimit të kontratës – Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas LPP-së, siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështesë përmbushjen e kontratës i cili do të mbetet valid për një periudhë prej (30) ditësh pas kompletimit të kontratës. Në dosjen e tenderit “Shërbime hoteliere për MKK” në vlerë 53,143€, ishte kërkuar siguria e ekzekutimit prej 10%, në afat prej 24 muajsh, deri në përfundimin e kontratës. Përfituesi i kontratës ka depozituar sigurinë e ekzekutimit të tenderit vetëm për 12 muaj.

Rreziku Depozitimi i sigurisë së ekzekutimit në afat më të shkurtër se afati i skadimit të kontratës, e pamundëson ndëshkimin ndaj OE në rast se kjo e fundit nuk ofron shërbimet e ofruara sipas kontratës.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e procedurave deri në lidhjen e kontratave. Operatorët fitues të tenderit, para nënshkrimit të kontratës duhet t’i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 300,000€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 299,993€, 100% të buxhetit. Mjetet e buxhetuara për këtë kategori shfrytëzohen për subvencionimin e OJQ-ve që kanë për qëllim integrimin, asistencën dhe rehabilitimin e Komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Zbatimi i kontrolleve menaxheriale në këtë kategori nuk ishte në nivel të kënaqshëm. Në vijim po i shpalosim mangësitë e identifikuara:

Çështja 11 - Subvencionimi i projekteve në kundërshtim me rregulloren e brendshme - Prioritet i lartë

E gjetura MKK ka nxjerr një rregullore të brendshme me nr.02/2012 për mënyrën e menaxhimit dhe raportimit për dhënien e subvencioneve të Organizatat jo Qeveritare (OJQ). Megjithatë testimet tona kanë nxjerr në pah të gjeturat në vijim:

- Në një rast komisioni për vlerësimin e projekteve kishte pohuar se OJQ kishte plotësuar të gjitha kushtet për dhënien e subvencionit sipas formularit për kriteret e plotësuar, ndërsa testet tona shpalosen se OJQ-ja nuk e ka plotësuar njërin nga kriteret e kërkuara (buxhetin e projektit në të cilin specifikohen të gjitha aktivitetet dhe çmimi kushtues i tyre). Kjo ka ndodhur në mungese të kontrollit të mirëfilltë nga ana e komisionit vlerësues;
- Në një rast OJQ kishte dorëzuar vetëm raportin financiar, pa i bashkangjitur dëshmitë mbështetëse si: faturat, dëftesat dhe dokumente tjera të cilat i dëshmojnë shpenzimet e raportuara. Ndërsa një rast tjetër OJQ-ja kishte dorëzuar raportin financiar të bashkangjitur me dëftesat dhe faturat, mirëpo ato nuk specifikonin se për çfarë qëllimi ishin kryer pagesat; dhe
- Me vendim të menaxhmentit janë shfrytëzuar mjetet nga kategoria e subvencioneve për blerjen e mobiljeve për familjet në nevojë. Vlera e blerjeve ishte 1,383€, në këtë rast është shfrytëzuar kontrata kornize për furnizim me mobilje dhe teknikë të bardhë. Me rregulloren e brendshme për subvencione nuk parashihet shpenzimi i subvencioneve për destinime humanitare.

Rreziku Mangësitë e përcjella me rastin e procesimit të subvencioneve që nga aplikimi, ndarja dhe raportimi, rrisin rrezikun që subvencionet të mos realizohen sipas kushteve dhe kriterëve të specifikuar me marrëveshje, dhe në këtë mënyrë të mos arrihen objektivat e synuara.

Rekomandimi 11 Ministri të ndërmarrë veprimet e nevojshme që të sigurojë se subvencionet realizohen në përputhje me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, duke iu përmbajtur kushteve dhe kriterëve të caktuar me marrëveshje.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,064,649€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 6,268,824€, ose 89%. Investimet kapitale kryesisht kanë të bëjnë me projektet për kthimin dhe ri-integrimin e komuniteteve dhe përkrahjen e tyre që është synim dhe objektive kryesore e MKK-së.

Çështja 12 - Paradhënie bashkëfinancimi jo në pajtueshmëri me ligjin - Prioritet i lartë

E gjetura

Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës nr. 05/L-071 për vitin 2016, në nenin 12, rregullohen rastet kur mund të japë paradhënie OB-ja për projektet kapitale, kurse neni 15, rregullon ndryshimet për shumatat e ndara për projektet kapitale brenda nën-programeve. Sipas marrëveshjes dhe projekt-buxhetit për mbështetjen e komuniteteve, në mes të IOM-it dhe MKK-së, ishte paraparë të transferohej vlera prej 2,000,000€ tek IOM-i gjatë tërë periudhës 2016-2017, në mënyrë që kjo e fundit të jetë zbatuese e projektit për ndërtimin e infrastrukturës së komuniteteve. Vetëm për vitin 2016 ishin paraparë të transferohen 1,000,000€.

Megjithatë, gjatë periudhës mars-dhjetor të vitit 2016, MKK kishte transferuar në llogari të IOM-it 2,153,719€. Përveç 1,000,000€ që ishin të buxhetuara të transferohen, janë transferuar edhe 1,153,720€ tjera të marra nga mjetet e buxhetuara për dy projektet tjera në kuadër të të njëjtit program (nga kodi i Projektit për të kthyerit 890,810€ dhe nga Projekti për të komunitete 262,909€). Menaxhmenti e kishte vlerësuar që obligimet ndaj organizatës në fjalë (IOM-it) të kryheshin para kohe, duke pasur parasysh faktorin e kushteve atmosferike, ndërsa, transferet tjera menaxhmenti i ka arsyetuar se MKK ishte në obligime të mëhershme ndaj IOM-it që nga viti 2015.

Më datën 26 tetor 2016 MKK, Komuna e Shtërpçës dhe KEDS-i kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit "Zhvendosja e rrjetit dhe trafos së tensionit të mesëm", për realizimin e projektit "Brezovica - Komuna e Shtërpçës". Vlera e parashikuar e këtij projekti ishte 106,000€ (MKK do të investojë 70,666€, ndërsa KEDS-i 35,334€).

Gjatë vitit 2016 MKK kishte transferuar në llogari të KEDS-it si paradhënie gjithë vlerën e përcaktuar me memorandum prej 70,666€. Megjithatë, marrëveshja ishte shume e mangët, sepse nuk e obligonte KEDS-in t'i raportojë MKK-së përmes raporteve narrative dhe financiare, as gjatë fazës së realizimit të projektit, as pas përfundimit të projektit. Si rrjedhojë MKK nuk kishte informata të plota rreth procesit të shpenzimit të mjeteve të veta. Menaxhmenti kishte caktuar një zyrtar kontaktues, i cili do t'i përcillte punët e kryera dhe do t'i raportonte menaxhmentit mirëpo raportet e tij nuk përmbanin informacione të plota që do ta arsyetonin shpenzimin. Për më tepër, çdo transfer i mjeteve është regjistruar si shpenzim, në mungesë të dëshmive mbështetëse (raportit të pranimit dhe faturës).

Rreziku Pagesat në parapagim bazuar vetëm në marrëveshjen përmes memorandumit të mirëkuptimit, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se marrëveshjet do të realizohen, sipas kërkesave të përcaktuara, ose ekziston rreziku për mos zbatimin e plotë të tyre. Si rrjedhojë objektivat e përcaktuara të MKK-së mund të mbesin të pa realizuara.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të sigurojë se lidhja e marrëveshjeve të bashkë financimeve të behet përmes një procesi të rregullt ligjor duke specifikuar të gjitha kriteret të cilat ofrojnë siguri të mjaftueshme për realizimin e projekteve. Me tutje, t'i forcoj kontrollet mbi mbikqyrjen e procesit të ekzekutimit përmes raporteve periodike narrative dhe financiare të mbështetura me dëshmi adekuate, të cilat dëshmojnë shpenzimet e krijuara.

3.1.5 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë paraqitur çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale.

Çështja 13 - Dobësi në procedurat e prokurimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas LPP, neni 8, parasheh që aktivitetet e prokurimit t'i paraprijë një plan i detajuar i cili bëhet në bazë të nevojave reale të organizatës. Ndërsa neni 9 i këtij ligji, përcakton që për zhvillimin e aktivitetet e prokurimit të cilat nuk janë të përfshira në planin përfundimtar të prokurimit, duhet që paraprakisht të bëhet njoftimi në AQP.

Në planin e prokurimit nuk ishin të përfshira të gjitha aktivitetet e kontraktuara gjatë vitit 2016. Në tri (3) procedura nuk ishte bërë njoftimi në AQP, si:

- Kontrata "Furnizimi me shërbime hoteliere në ndërtesën e MKK-së", në vlerë 53,143€
- Kontrata "Furnizim më kamera vëzhgimi" në vlerë 46,640€; dhe
- Kontrata "Furnizim me mobilje", në vlerë 9,938€.

Sipas Zyrtari i prokurimit, arsyet e mos njoftimit në AQP, ishin: humbja në kohë për zhvillimin procedurave të prokurimit, kontratat e natyrës së njëjtë, si dhe vlerat e vogla.

Rreziku Mospërfillja e kërkesave ligjore mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit, mund të rezultojë me mangësi që shpijnë në dështimin e kontratave të planifikuara.

Rekomandimi 13 Ministri të duhet të rishikojë arsyet për dështimin e kontrolleve dhe të marrë masa dhe veprime për forcimin e tyre, në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në përputhje të plotë me kërkesat e LPP-së.

Çështja 14 - Dobësi në procesimin e pagesave - Prioritet i mesëm

E gjetura Rregulla financiare 01/2013 i përcakton hapat për procedimin e pagesave. Fillimisht behet kërkesa për blerje, urdhër blerja, raporti i pranimit e më pas fatura.

Në shtatë (7) pagesa kemi vërejtur se urdhër blerja dhe raporti i pranimit të mallit, janë gjeneruar pas pranimit të faturës. Arsyetimi i zyrtarëve përgjegjës ishte se në raste të tilla, nuk kanë mundur t'i sigurojnë me kohë të dhënat mbi furnitorin.

Sipas rregullës financiare 01/2013, neni 24, të gjitha faturat duhet të pranohen/protokolohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit. Në 21 pagesa, vërejtëm se faturat nuk ishin pranuar përmes zyrës së arkivit por ishin pranuar në zyrën e prokurimit, ku ishin evidentuar me një numër por pa vulë të protokollit. Me ç'rast në një rast një faturë nuk ishte evidentuar fare. Gjithashtu, nuk kishte dëshmi se cili zyrtar e bën pranimin/protokollimin e faturave. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos familjarizimit të stafit me rregullat financiare.

Rreziku Pranimi i faturës në mungesë të urdhër blerjes dhe raportit mbi pranimin e mallit, rrezikon që mallrat e pranuar të mos janë në cilësinë dhe sasinë e duhur. Ndërsa si rrjedhojë e mos protokollimit të faturave përmes zyrës së arkivit, ekziston rreziku që faturat të mos evidentohen në mënyrë të rregullt duke shkaktuar evidenca jo të plota të faturave të pranuar dhe rritje të obligimeve të papaguara.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të rishikojë arsyet e vazhdimësisë së mangësive në procedimin e pagesave dhe të sigurojë zbatimin e kontrolleve efektive në këtë fushë. Të sigurojë se është bërë ndarja e duhur e detyrave, që faturat pranohen dhe protokolohen në zyrën e arkivit, e me pastaj të shpërndahen në njësitë përkatëse.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë neto të MKK-së ishin 1,426,410€. Prej tyre 1,409,696€ ishin pasuritë më vlerë mbi 1,000€, 11,412€ pasuritë nën vlerën 1,000€, ndërsa stoqet në fund të vitit 5,302€. Ne kemi testuar pasuritë që rrjedhin nga investimet kapitale gjatë vitit 2016, si dhe rregullsinë në evidentimin e pasurisë në dispozicion. Ne kemi bërë edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurisë.

Bazuar në këtë kemi identifikuar mangësitë si në vijim.

Çështja 15 - Regjistra jo të plotë të pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura Menaxhimi i pasurisë nuk është bërë në përputhje me kornizën ligjore për menaxhimin dhe raportimin e tyre. Në vijim kemi shpalosur mangësitë e evidentuara:

- Sipas Rregullës financiare 02/2013 për pasuritë jo financiare, neni 18, inventarizimi i pasurisë bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. MKK kishte bërë inventarizimin e pasurisë, mirëpo ky raport nuk është krahasuar me regjistrat e pasurisë për të identifikuar diferencat;
- Gjatë testimit të pasurive jokapitale nën 1,000€ në sistemin e-pasuria, kemi vërejtur që një numër i konsiderueshëm i pajisjeve të IT-së dhe pajisjeve tjera nuk janë zhvlerësuar në bazë të normave të përcaktuara të zhvlerësimit. Zyrtari përgjegjës kishte kontaktuar me MAP-in lidhur me këtë problem, mirëpo ende nuk kishin marrë ndonjë përgjigje konkrete.
- MKK ka bërë pranimin e pasurive në vlerë prej 9,938€, mirëpo ato nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Kjo kishte ndodhur pasi që pranimi është bërë direkt nga furnitori tek përfituesi;
- Në bazë të komisionit për regjistrimin e automjeteve ishte konstatuar se MKK posedon gjithsej 48 vetura. Ndërsa në regjistrin e pasurive kapitale, në fazën fillestare ishin të regjistruara vetëm 20 prej tyre. Pas vërejtjes tonë, në fazën finale zyrtari i pasurisë kishte regjistruar edhe katër vetura tjera, mirëpo pjesa tjetër nuk ishte regjistruar për shkak të pamundësisë së bartjes së veturave me vlerë zero në regjistrat e pasurive kapitale; dhe
- Në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ figurojnë shtatë (7) fotokopje dhe një (1) llaptop, për të cilat nuk ka dëshmi rreth ekzistencës apo pronësisë së tyre, pasi që ato nuk janë evidentuar në sistemin e depos. Zyrtari i pasurisë nuk kishte informacion rreth regjistrimit të këtyre pasurive në SIMFK pasi që në kohën kur ishin regjistruar ato ai nuk kishte qenë në këtë pozitë.

Rreziku Në mungesë të evidencave të plota menaxhmenti nuk ka të dhëna të sakta mbi pasurinë e saj, andaj ekziston rreziku i humbjes apo keqpërdorimit të tyre. Informatat financiare ekzistuese mund të mos përmbushin kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Kjo pamundëson një menaxhim efektiv dhe kontroll mbi pasuritë.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontroleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura për përmirësimin e menaxhimit të tyre. Në rast nevojë zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit për menaxhimin e pasurisë.

Çështja - 16 Shfrytëzimi i automjeteve jashtë limiteve të lejuara - Prioritet i lartë

E gjetura Në UA 03/2008, janë përcaktuar kategoritë e zyrtarëve që kanë të drejtë shfrytëzimin e veturave zyrtare në kohëzgjatje 24h. MKK, nuk kishte respektuar këtë udhëzim, duke lejuar që përmes një vendimi të lëshuar në gusht 2015, t'i mundësohet shfrytëzimi i veturës zyrtare 24h, personit i cili nuk është punonjës i ministrisë. Vlera e karburanteve të paguara nga ministria për këtë veturë në vitin 2016 ishte 2,352€. Gjithashtu, nuk kishte evidenca mbi mënyrën e shfrytëzimit të saj.

Vendime mbi shfrytëzimin 24h të veturave zyrtare ju kishin lëshuar edhe pesë (5) këshilltarëve politik, si dhe shefit të kabinetit të Ministrit. Shumica prej tyre nuk i plotësojnë fare fletudhëtimet mbi shfrytëzimin e automjeteve.

Rreziku Dhënia në shfrytëzim 24h e veturës zyrtare, personit jashtë ministrisë, përbën keqpërdorim të pasurisë publike. Ndërkaq, shfrytëzimi i veturave nga stafi i cili nuk ka të drejtë përdorimi 24h, si dhe mos raportimi i tyre rrezikon përdorimin e veturave për qëllime jozyrtare.

Rekomandimi 16 Ministri të sigurojë se janë marrë masat për ndalimin e përdorimit të veturës zyrtare, personit që nuk është punonjës i ministrisë. Të rishikojë vendimet për stafin që nuk ka të drejtë përdorimi 24h të veturave zyrtare dhe të sigurojë se raportimi mbi shfrytëzimin e veturave të jetë i plotë.

3.3 Obligimet e papaguara

MKK i kishte përmbyllur të gjitha obligimet ndaj furnitorëve të pranuar gjatë vitit 2016. Ishin përgatitur raportet e rregullta mujore për raportim të faturave të papaguara në thesar.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3. Implementimi i rekomandimeve	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP-ja, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Po		
2.4. Lista kontrolluese	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
2.5.1. Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		Pjesërisht i zbatuar. Është hartuar regjistri por nuk janë identifikuar masat që do të ndërmerren në rast të ballafaqimit me këto rreziqe.	
6.1. NjAB	Ministri përmes Komitetit të Auditimit duhet të rishikoj në mënyrë kritike performancën e NJAB-së, përfshirë planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e kësaj njësie. Gjithashtu të sigurojë se kjo njësi ka kualifikimet e duhura dhe përcjell mjaftueshëm ndryshimet në kornizën ligjore.	Po		

3.3. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të siguroj se janë forcuar linjat raportuese dhe stafi menaxhues duhet të mbahet përgjegjës për cilësinë e regjistrimit dhe klasifikimit të saktë të shpenzimeve.			Nuk janë marrë masa.
3.4. Prokurimi	Ministri duhet të sigurojnë se janë forcuar kontrollet në procesin e realizimit të pagesave, respektivisht të ndjekin në mënyrë kronologjike të gjithë hapat e përcaktuar më rregulla të thesarit.		Në proces të zbatimit. MKK ka përmirësuar sistemin e ekzekutimit të pagesave, mirëpo ne kemi vërejtur parregullsi edhe gjatë vitit 2016.	
3.4. Prokurimi	Ministri në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të siguroj mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Po		
3.4. Prokurimi	Ministri duhet të siguroj kontrole shtesë në mënyrë që i gjithë stafi të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore, përfshirë edhe kërkesat ligjore të Ligjit mbi tatimin në të ardhurat personale.	Po		
3.5.2. Pagat	Ministri duhet të sigurojë se listat e pagave (payroll) janë të përgatitura në pajtueshmëri me Akt emërimet për secilin të punësuar, përfshirë pozitën dhe koeficientin e pagesës.	Po		
3.5.2. Subvencionet & Transferet	Ministri duhet të siguroj se janë identifikuar qartë nevojat për subvencione dhe transfere, brenda fushës së përgjegjësisë së tyre. Me tutje të gjitha pagesat nga kjo kategori duhet të bëhen vetëm për raste të cilat kanë karakterin e kësaj natyre.			Nuk janë marrë masa.

3.6.1. Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ministri duhet të sigurojë se bëhet një analizë e arsyeve për mos regjistrimit të plotë të pasurisë dhe të sigurojë se ky regjister është plotësuar më informatat e nevojshme. Procesi i inventarizimit të pasurisë duhet të përfundohet para përgatitjes së pasqyrave financiare. Raporti i nxjerrë nga ky proces duhet të harmonizohet më regjistrin e përgjithshëm të pasurisë për të identifikuar pasurinë e pa evidentuar. Me tutje të gjitha investimet e bëra për komunat dhe komunitetin duhet të tjetërsohen (bartën të përfituesit) si pasuri jo financiare.		Në proces të zbatimit. Kishte filluar procesi i regjistrimit të pasurisë, megjithatë nuk ishte bërë në mënyrën e duhur. Ende nuk janë krijuar kushtet për tjetërsimin e pasurisë e cila nuk shfrytëzohet nga organizata.	
3.6.1. Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ministri të rishikoj marrëveshjet ekzistuese për dhënien e veturave, dhe në rast të mungesës së ligjshmërisë së tyre t'i shfuqizoj ato marrëveshje dhe të siguroj kthimin e veturave në ministri.	Po		
3.6.2. Trajtimi i obligimeve	Ministri duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar mënyrën e raportimit të obligimeve, qoftë përmes trajnimit të stafit, ose përmes formave tjera.	Po		

Shtojca IV: Letërkonfirmimi

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin 2016 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Nenad Stojcetovic

Sekretar i Përgjithshëm

Data: 31.05.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS

РЕПУБЛИКА КОСОВО / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA/ ВЛАДА/ GOVERNMENT

MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM / МИНИСТАРСТВО ЗА ЗАЈЕДНИЦЕ И ПОВРАТАК
/ MINISTRY FOR COMMUNITIES AND RETURN

PISMO KONFIRMACIJE

O usklađenosti sa nalazima Generalnog Revizora za 2016 godinu. i sprovođenju preporuke

Za: Kancelariju Generalnog Revizora

Poštovani,

Sa ovim pismom, potvrđujem da:

- primio sam nacrt izveštaj Kancelarije Generalnog Revizora o reviziji Finansijskih Izveštaja Ministarstva za Zajednice i Povratak za 2016. godinu (u daljem tekstu: "Izveštaj");
- slažem se sa nalazima i preporukama i nemam neki komentar o sadržaju Izveštaja; i
- U roku od 30 dana od dana prijema konačnog izveštaja, dostavljaću vam akcioni plan za implementaciju preporuka, koje će uključivati rokove i odgovorne osoblje za implementaciju.

G-dine: Nenad Stojcetovic,.....

Generalni Sekretar Ministarstva za Zajednice i Povratak

Datum: 31.05.2017